

K Ë R K E S Ë

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË RRETHIT GJYQËSOR TË FIERIT

Kërkuese: Margarita Dhoska, e bija e Mistos dhe e Dhoksisë, e datëlindjes 1930, lindur në Përmet dhe banuese në qytetin e Patosit.

Objekti: Shpalljen të vdekur të Nastas Dhosk Dhoska në bazë të neneve 15 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe 375 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Unë kërkuesja Margarita Dhoska jam nusja e djalit të Nastas Dhoska, i cili ka patur si banim të fundit të tij në Shqipëri, qytetin e Patosit nga dhe është larguar për në Stamboll të Turqisë që në vitin 1926, i cili ka banuar përherë në Turqi, ndërsa gruan e tij të quajtur Agllahi Dhoska dhe të birin Dhosi i la këtu në Shqipëri.

Theksoj se të dy personat në ngarkim të tij kanë vdekur në vitet 1981 e 1993 dhe në certifikatën e gjendjes familjare figurojmë: unë kërkuesja dhe personi që kërkohet të shpallet i vdekur, i cili është vjerri im.

Ka mbi 20 vjet që ne nuk kemi asnjë të dhënë mbi ekzistencën e tij nëse është i gjallë apo ka vdekur dhe nga të gjithë njerëzit që janë interesuar në këtë shtet, nuk na kanë dhënë të dhënba mbi të, por ka shumë mundësi të ketë vdekur edhe për vetë datëlindjen e tij të hershme 7.3.1900.

Në këto kushte kërkoj që vjehri im Nastas Dhoska të shpallet i vdekur.

KËRKUESJA
Margarita Dhoska